

Timothy Keller

Thyerja e Barrierave: Si i Kapërcen Ungjilli Dallimet Kulturore

Veprat e Apostujve 8:26-40

²⁶ Dhe një engjëll i Zotit i foli Filipit, duke i thënë: “Çohu dhe shko drejt jugut, në rrugën që nga Jeruzalemi zbrit në Gaza; ajo është e shkretë.” ²⁷ Ai u ngrit dhe u nis; dhe ja, një njeri Etiopas, eunuk, një zyrtar i lartë i Kandaces, mbretëreshës së Etiopisë, përgjegjës i të gjitha thesareve të saj, i cili kishte ardhur në Jeruzalem për të adhuruar.

²⁸ Tani ai po kthehej dhe, i ulur në karrocën e vet, lexonte profetin Isaia.²⁹ Dhe Fryma i tha Filipit: “Afrohu dhe arrije atë karrocë!” ³⁰ Filipi iu turr afër dhe, duke dëgjuar se po lexonte profetin Isaia, i tha: “A e kupton atë që lexon?”

³¹ Ai tha: “E si do të mundja, po s’pata një që të më udhëzojë?” Pastaj iu lut Filipit të hipë dhe të ulet pranë tij. ³² Por pjesa e Shkrimit që ai po lexonte ishte kjo: “Atë e çuan si delja në thertore; dhe ashtu si qengji është memec përpara qethtarit, kështu ai nuk e hapi gojën e vet. ³³ Në përluljen e tij iu mohua çfarëdolloj drejtësie; po kush do të mund ta përshkruajë brezin e tij? Sepse jeta e tij u hoq nga toka.”

³⁴ Dhe eunuku iu kthye Filipit dhe tha: “Të lutem, për kë e thotë profeti këtë? Për veten e vet apo për ndonjë tjetër?” ³⁵ Atëherë e mori fjalën Filipi dhe, duke filluar nga ky Shkrim, i shpalli Jezusin. ³⁶ Dhe, ndërsa po vazhdonin rrugën, arritën në një vend me ujë. Dhe eunuku tha: “Ja uji! Çfarë më pengon të pagëzohem?”

³⁷ Dhe Filipi tha: “Nëse ti beson me gjithë zemër, mund ta bësh.” Dhe ai u përgjigj duke thënë: “Unë besoj se Jezu Krishti është Biri i Perëndisë.”

³⁸ Urdhëroi atëherë të ndalet karroca, dhe të dy, Filipi dhe eunuku, zbritën në ujë dhe ai e pagëzoi. ³⁹ Kur dolën nga uji, Fryma e Zotit e rrëmbeu Filipin dhe eunuku nuk e pa më; por e vazhdoi rrugën e tij me plot gëzim. ⁴⁰ Por Filipi u gjet në Azot; dhe, duke vazhduar, ungjillëzoi të gjitha qytetet, derisa arriti në Cezare.

Libri i Veprave të Apostujve regjistron fillimet më të hershme të krishterimit pas kthimit të Krishtit në qiell. Ai na mëson për karakterin e të krishterëve më të hershëm dhe se si fuqia e Perëndisë përmbysi botën. Dhe sa më shumë e konsideroj këtë histori të Filipit dhe etiopiasit, aq më shumë e shoh me habi.

Ky pasazh sjell ndërmend një varg të vetëm në një poezi të Xhorxh Herbert, një poet i shekullit të shtatëmbëdhjetë. Ajo thotë kështu: "Bibla të hapura, miliona surpriza..." Pavarësisht se kush jeni, Bibla do t'ju befasojë. Pavarësisht se cila është kultura apo

klasa juaj, pavarësisht se me çfarë paragjykimesh vini në Bibël, ajo do të përballet me ta.

Ky është një tekst befasues, që rrënon kategorinë. Do të doja ta shikoja atë përmes tre parimeve të ndryshme që na mëson. Si fillim, na tregon për *gjithëpërfshirjen e krishterimit*. Së dyti, na tregon për *përrjashtueshmërinë e krishterimit*. Më në fund, mësojmë *argumentimin dhe bazën për të dyja*. Shumica e njerëzve thonë, "Epo, ju jeni ose gjithëpërfshirës ose përrjashtues", por fakti është se krishterimi është rrënjësisht gjithëpërfshirës dhe tejet përrjashtues. Mund të jetë të dyja sepse është të dyja.

Gjithëpërfshirja e Krishterimit

Na thuhet se figura kryesore në histori është një eunuk etiopias. Në atë kohë, Etiopia i referohej rajonit të Nilit të Epërm të Afrikës nga veriu deri në Asuan dhe deri në jug, deri në Khartoum. Sot, ne e quajmë atë Nubia.

Për më tepër, ai ishte eunuk. Ai ishte tredhur. Për njerëzit në pozitën e tij, kjo ishte e zakonshme. Nëse nuk ishit pjesë e familjes mbretërore, por po përgatiteshit për udhëheqje administrative në qeveri dhe ishit në afërsi me anëtarët e familjes mbretërore, çmimi ishte tredhja. Largonte tundimin nga ana e administratorit dhe dyshimin nga ana e familjes mbretërore, por me një kosto të tmerrshme.

Menjëherë vëmë re dy gjëra. Së pari, sa të ndryshëm janë të dy njerëzit në këtë histori. Filipi ishte një hebre i klasës së mesme. Ky njeri në karrocë ishte me ngjyrë. Ai ishte nga pjesa më e jashtme e botës së njohur të qytetëruar. Ai ishte ndryshuar seksualisht. Nga këndvështrimi i kulturës së Filipit, ky burrë do të ishte konsideruar si një barbar i ndryshëm nga pikëpamja racore, seksualisht i ndryshuar – aq ndryshe nga Filip sa mund të ishte!

Në ato ditë, burrat hebrenj ngriheshin çdo ditë dhe luteshin: "O Zot, të falënderoj që nuk më bërë grua, skllav apo johebre". Atyre iu thuhej: "Ju nuk duhet të shoqëroheni me njerëz që janë të ndryshëm nga ju, sepse kjo ju ndot." Megjithatë, etiopiasit ishte pothuajse po aq i ndryshëm nga Filipi sa mund të ishte një person.

Gjëra e dytë që duhet vënë re është se sa e drejtpërdrejtë duhej të ishte ndërhyrja e Zotit në mënyrë që të bëhej kjo lidhje. Në vargun 26, një engjëll i Zotit i tha Filipit të shkonte në rrugën që zbret nga Jeruzalemi në Gaza. Së dyti, vargu 29 thotë se kur ai sheh etiopiasin, "**Fryma i tha Filipit: 'Afrohu dhe arrije atë karrocë!'**". **Pastaj Filipi vrapoi drejt karrocës...**"

A e dini pse Fryma duhej të thoshte: "Ngjitu te karroca dhe qëndro pranë saj"? Sepse ajo po lëvizte. Ai duhej të vraponte! Ai nuk u ftua në karrocë deri në vargun 31, kështu që kush e di se sa kohë iu desh të vraponte me të para se të vihej re. Deri atëherë, ai duhet të ketë vrapuar me të, duke pritur për të parë se çfarë kishte në mendje Perëndia. Atëherë eunuku e ftoi Filipin të vinte dhe të ulej me të. (E keni menduar ndonjëherë pse

do ta bënte këtë? Ai mori një djalë që as nuk po bënte autostop!) Pasi hyri brenda, Filipi e shfrytëzoi menjëherë një gjë të përbashkët që bashkon burrat që në dukje janë shumë të ndryshëm: Biblën. Ai pa se etiopiasit po lexonte Shkrimin dhe e pyeti: "A e kupton atë që po lexon?" Kjo nuk ishte mënyra e zakonshme se si zhvilloheshin takimet e rastësishme në rrugë.

Mbani në mend se ky takim nuk do të kishte ndodhur kurrë nëse Fryma nuk do të kishte thënë të shkante dhe të vraponte me të. Dhe na thuhet në fund, në vargun 39, se sapo ndodhi pagëzimi, Fryma e mori Filipin. Nuk e dimë saktësisht se si e bëri atë, por është një fjalë që fjalë për fjalë do të thotë *kap*. Fryma e kapi Filipin dhe e mori me vete. Në çdo përmasë, ky ishte një takim hyjnor. Çdo aspekt i saj ndodhi për shkak të ndërhyrjes hyjnore.

Ne mund të mësojmë dy gjëra të rëndësishme nga mënyra se si u organizua kjo. Para së gjithash, Fryma e Perëndisë dëshiron fort që të kapërcehen barrierat racore midis njerëzve. Është një nga temat më të dukshme në librin e Veprave të Apostujve. Pa pushim, Fryma i nxit të krishterët të thyejnë barrierat, të dalin nga zona e tyre e rehatisë dhe të përqafojnë njerëz të racave, kulturave dhe vendndodhjeve të ndryshme.

Bibla flet për trishtimin e Frymës nëse ne nuk duam atë që do Perëndia. Kjo duhet të nënkuptojë se e pikëllon Perëndinë kur të krishterët e një race tregojnë përbuzje ose injorojnë njerëzit e racave, temperamenteve, klasave dhe kulturave të tjera. E hidhëron Frymën. Ne duhet të dëgjojmë zërin e Frymës, miq. Ja ku është: Filip, vrapo drejt atij burri të ndryshëm racor, seksualisht të ndryshuar me të cilin zakonisht nuk do të kishte të bëjë... dhe *qëndro afër*. Kjo është trajektorja e Frymës në të gjithë librin e Veprave të Apostujve dhe është *ende* trajektorja e Frymës. Fryma e Perëndisë dëshiron që barrierat racore, ekonomike dhe personale të kapërcehen. Dhe fillon duke bërë përpjekje (ju mendoni se ishte e lehtë të mbante vrapin me një karrocë që tërhiqej nga kuajt?) për të qëndruar afër. Si fillim, mos flisni, mos detyroni njeri - prisni që t'ju ftojnë dhe thjesht qëndroni afër.

Së dyti, gjëja tjetër që mësojmë këtu është se krishterimi nuk i përket një kulture më shumë se një tjetre. Vazhdimisht, në librin e Veprave të Apostujve, ne shohim johebrenj që kthehen në besim. Së pari, samaritanët u kthyen në besim. Edhe pse ishin gjeografikisht të afërt, samaritanët u tjetërsuan racialisht nga judenjtë, sepse të dy grupet e urrenin njëri-tjetrin.

Tani kthehet në besim një afrikan me ngjyrë, dikush që nuk është vetëm i ndryshëm nga pikëpamja racore, por edhe gjeografikisht nga skajet e largëta të botës së atëhershme. Më vonë në libër, ne shohim një farise jude që kthehet në besim nga ungjilli. Pastaj, romakët kthehen në besim nga ungjilli. Pa pushim, libri i Veprave të Apostujve nuk e favorizon një kulturë së cilës krishterimi i përket më shumë se një tjetre.

Gjatë ngjitjes së Jezusit në qiell, Luka 24 thotë se ai u dha pasuesve të tij këtë urdhër:

⁴⁶ dhe u tha atyre: “Kështu është shkruar dhe kështu ishte e nevojshme që Krishti të vuante dhe të ngjallej së vdekuri ditën e tretë, ⁴⁷ dhe që në emër të tij të predikohet pendimi dhe falja e mëkateve ndër të gjithë popujt, duke filluar nga Jeruzalemi.

Mateu regjistron të njëjtin rast në kapitullin 28, duke thënë:

¹⁸ Pastaj Jezusi u afrua dhe u foli atyre duke thënë: “Mua më është dhënë çdo pushtet në qiell e në tokë. ¹⁹ Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë, ²⁰ dhe duke i mësuar të zbatojnë të gjitha gjërat që unë ju kam urdhëruar. Dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës. Amen.”

A e dini se si kjo e vë Biblën në konflikt të drejtpërdrejtë me të kuptuarit e zakonshëm se si kultura dhe feja ndërlidhen? Sot, shumica e kolegjeve ose shkollave mësojnë se feja është vetëm një shtrirje ose një funksion i kulturës. Nuk është e pazakontë që nxënësit të dëgjojnë diçka të tillë si: “Feja është shpikje e kulturës, sepse çdo kulturë ka nevojë për solidaritet. Në çdo kulturë, njerëzit kanë nevojë për përputhje të plotë të bazuar në zakone dhe vlera të përbashkëta për ta mbajtur atë kulturë të bashkuar. Një nga mënyrat për ta bërë këtë është t'i vësh në pah këto histori metafizike, shpirtërore që bëhen fe. Pra, evropianët dhe amerikanët e veriut zhvilluan krishterimin, kulturat e Azisë Jugore zhvilluan hinduizmin, kulturat e Lindjes së Largët zhvilluan budizmin, konfucianizmin dhe shintoizmin, dhe Lindja e Mesme, Afrika Veriore dhe disa kultura të Azisë Jugore zhvilluan islamin. Çdo kulturë zhvillon një fe si një zgjatim i vetvetes, dhe kjo është e gjitha çfarë feja është.”

Lamin Sanneh, një profesor afrikan në Jale (dhe një i krishterë), shkroi një libër të vogël të mrekullueshëm disa vite më parë të quajtur, *Whose Religion is Christianity? The Gospel Beyond the West. (Feja e Kujt Është Krishterimi? Ungjilli Përtej Perëndimit)*. Ai thekson se nëse shikoni se ku janë qendrat e popullsisë për fetë kryesore botërore, qendrat e tyre të popullsisë janë ende afërsisht aty ku filluan - me përjashtim të krishterimit.

Shumica e adhuruesve të feve të tjera janë ende të vendosur në kulturat ku janë zhvilluar ato fe. Për shembull, 88% përqind e budistëve jetojnë në Azinë Lindore dhe 98% përqind e hindusve jetojnë në Indi ose Azinë Jugore. Kjo, natyrisht, mbështet teorinë se feja është vetëm një zgjatim i kulturës.

Por Sanneh thekson se krishterimi është absolutisht i ndryshëm. Është e vetmja fe në mbarë botën: 26% e të krishterëve janë në Evropë, 25% janë në Amerikën Latine dhe

Karaibe, 24% janë në Afrikë dhe 13% janë në Azi, por ky numër po rritet shumë shpejt. Vetëm 12% e të gjithë të krishterëve në botë janë në Amerikën e Veriut.

Koreja kaloi nga 0% e një popullsie të krishterë në rreth 40 ose 50% të një popullsie në rreth 100 vjet. Kina - e cila është pak më e madhe se Koreja, meqë ra fjala - po bën të njëjtën gjë tani për një periudhë 100-vjeçare (prandaj thashë se përqindja e të krishterëve në Azi po rritet shumë shpejt). Afrika u shndërrua nga rreth 9% e krishterë në 50% e krishterë në 100 vjet.

Asnjë fe tjetër nuk ka lëvizur ndonjëherë në një kontinent krejt të ri në atë mënyrë. Thjesht nuk ka ndodhur kurrë më parë. Në fakt, Riçard Baukham, një studiues në Universitetin e St.Andreus në Skoci, thotë: "Pothuajse me siguri, krishterimi shfaq më shumë larmishmëri kulturore se çdo fe tjetër, dhe kjo duhet t'na tregoj diçka për të." Absolutisht, ajo na tregon diçka në lidhje me të. Pse krishterimi është shumë më gjithëpërfshirës i larmisë kulturore se çdo fe tjetër dhe, për rrjedhojë është me të vërtetë e vetmja fe mbarë botërore dhe kulturalisht e larmishme?

Sanneh jep një shembull nga perspektiva afrikane. Ai na thotë të marrim parasysh këtë: afrikanët gjithmonë kanë besuar se bota ishte një vend i mbinatyrshëm. Ata gjithmonë kanë besuar se bota ishte e mbushur me shpirtra, të mirë dhe të këqij. Kjo është në thelb të asaj se çfarë do të thotë të jesh afrikan. Por çfarë duhet bërë me shpirtrat e këqij? Ata janë të fuqishëm. Ata mund t'ju joshin drejt së keqes dhe t'ju dominojnë. Si mund të shmangët kjo?

Shumë mjedise që përkrahin gjithëpërfshirjen e gjejnë veten ende të papajisur për t'iu përgjigjur shqetësimeve kulturore si këto. Për shembull, Sanneh thotë se nëse një afrikan shkon në një vend laik ose në një shkollë laike si Oksford, Jale, Princeton ose të ngjashme, këto vende zakonisht do t'u thonë: "Oh, ne jemi shumë përfshirës. Ne jemi multikulturorë. Ne jemi shumë të lumtur që ju hani ushqimin tuaj afrikan dhe vishni fustanin tuaj afrikan." Por nga e njëjta gojë, ata do t'u thonë gjithashtu se nuk ka shpirtra. "Nuk ka demonë, engjëj, asnjë nga këto gjëra. Gjithçka ka një shpjegim shkencor." Me fjalë të tjera, Sanneh thotë, ata thonë: "Ne e duam vërtet kulturën tuaj; ne thjesht do t'i heqim zemrën. Ju megjithatë duhet të bëheni perëndimor i vonshëm-modern, laik, individualist si ne, përndryshe nuk je i iluminuar." Kjo nuk është gjithëpërfshirëse! Kjo është shfrytëzuese.

Por, siç thotë edhe Sanneh, kur krishterimi vjen në Afrikë, ai vjen kështu: krishterimi sfidon dhe megjithatë pranon "afrikanizmin". Ai thotë: "Nga njëra anë, keni të drejtë: bota është një vend i mbinatyrshëm. Ka shumë shpirtra të mirë dhe shpirtra të këqij. Por ekziston dikush që i ka mundur shpirtrat e këqij: Jezu Krishti. Dhe nëpërmjet tij, ju mund

t'i mposhtni edhe ata." Sanneh thotë se kjo konfirmon afrikanizmin dhe megjithatë e ripërtërinë atë:

"Afrikanët e ndienin në zemrat e tyre se Jezusi nuk tallej me respektin e tyre për të shenjtën apo britmën e tyre për një Shpëtimtar të pamposhtur, kështu që ata i binin daulteve të tyre të shenjta për të derisa yjet hidheshin dhe kërcenin në qiell. Pas atij kërcimi, yjet nuk ishin më të vegjël. Krishterimi i ndihmoi afrikanët të bëheshin afrikanë të përtërirë, jo evropianë të ribërë."

Me fjalë të tjera, krishterimi është shumë më gjithëpërfshirës se sekularizmi, i cili gjithmonë flet për gjithëpërfshirje. Krishterimi nuk i përket vetëm kësaj kulture apo asaj kulture. Nuk është një shtrirje, funksion apo produkt i kulturës. Zbret nga lart. Ai qëndron mbi të gjithë kulturën dhe është puna e Frymës së Shenjtë të rikrijojë krishterimin në tokën e çdo kulture. Prandaj, krishterimi është feja më gjithëpërfshirëse nga të gjitha fetë – edhe më gjithëpërfshirëse se sekularizmi.

Përrjashtueshmëria e Krishterimit

Kjo pikë është më e shkurtër dhe unë do t'ju them pse. Nëse jetoni në një mjedis që vlerëson gjithëpërfshirjen, me siguri po fitoni këtë ndjenjë të mirë nga e gjithë kjo bisedë për gjithëpërfshirjen. Mjafton vetëm të dëgjosh fjalën "gjithëpërfshirje" për ta bërë Manhtan-in mesatar të ndihet i ngrohtë dhe i mjegullt përbrenda. Të shohësh vërtet prova empirike se krishterimi është feja më gjithëpërfshirëse e dallimeve kulturore thjesht ka një ndjenjë të këndshme, apo jo?

Por nëse doni të kuptoni pse krishterimi është më gjithëpërfshirës kulturalisht se sekularizmi apo se fetë e tjera, duhet të shihni se si është *përrjashtues*. Arsyeja pse kjo është një pikë e shkurtër është se ndoshta nuk duhen aq shumë argumente për të vërtetuar se krishterimi bën pretendime përrjashtuese. Ju mund t'i shihni ato këtu.

Për shembull, eunuku etiopias po lexonte rrotullën e Isaisë kur e pyeti Filipin: "Çfarë do të thotë ky tekst?" në vargun 34. Me sa duket, Filipin nuk u përgjigj në një mënyrë postmoderne, letrare, teorike. Ai nuk tha: "Ti duhet ta krijosh vetë kuptimin e tekstit. Ti duhet të vendosësh se çfarë është e drejtë apo e gabuar për ty. Unë nuk të them dot." Ai i tha se Jezusi është parimi hermeneutik dhe interpretues që ka kuptim për gjithçka në Bibël. Ai i tregoi atij ungjillin. Atëherë eunuku pyeti: "Pse të mos pagëzohem?" Duke kërkuar të pagëzohej, burri shpalli kthimin e tij në besim dhe besimin e tij në Jezusin dhe synimin e tij për t'u identifikuar me popullin e Perëndisë.

Pagëzimi do të thotë se një mënyrë jetese ka mbaruar dhe një mënyrë e re jetese fillon. Pagëzimi do të thotë të ndaloj së besuari *atë* dhe të filloj ta besoj *këtë*. Ndaloj së jetuari në *atë* mënyrë; filloj të jetoj në *këtë* mënyrë. Ai është konvertuar. Atij nuk iu tha: "Epo,

duhet t'i shërbesh Perëndisë dhe ta gjesh Perëndinë në çfarëdo mënyre që është më kuptimplotë për ty."

Pra, ndërsa mund të argumentoni se krishterimi është feja kulturalisht më gjithëpërfshirëse që mund të gjendet, mund të thoni gjithashtu se është feja më *përrjashtuese*. Nëse është më gjithëpërfshirëse se fetë e tjera, është gjithashtu më përrjashtuese. Si është kjo e mundur? Epo, çdo fe tjetër ka një themelues që në thelb është një profet, një i urtë ose një mësues i mençur që thotë: "Ja se si të arrish te Zoti". Përfytyrimi të cilit shpesh i referohet është se çdo fe është një rrugë e ndryshme deri në majën e malit, por ne të gjithë po shkojmë tek i njëjti Zot. Budistët thonë se rruga drejt Zotit është të ndjekësh Rrugën e Tetëfishit, dhe myslimanët thonë se rruga drejt Zotit është të praktikosh Pesë Shtyllat. Ata mund të duket se mësojnë praktika të ndryshme, por supozohet se të gjithë do të arrijnë te Zoti në majë të malit, secili nëpërmjet përpjekjeve të veta dhe respektimit të mësimeve të ndryshme. Janë shtigje të ndryshme për në majë, por secili duhet të ngjitet në majë me përpjekjet e veta.

Përveç krishterimit. Siç themi shpesh, Jezu Krishti nuk thotë: "Unë jam këtu për t'ju treguar se si ta gjeni Perëndinë". Jezu Krishti thotë: "*Unë jam* Perëndia dhe erdha t'ju gjej. Ju kurrë nuk do të arrini në majën e malit vetë. Unë kam ardhur sepse *Unë jam* Perëndia që ju po kërkon." Nëse kjo është e vërtetë, atëherë krishterimi është ose më i mirë se fetë e tjera të botës ose është më i keq, sepse atëherë Jezusi do të kishte thënë gënjeshtër më të madhe në botë. Ai ose duhet të jetë më i mirë se fetë e tjera ose më i keq se të tjerat. Nuk mund të jetë gjë tjetër. A nuk është ironike kjo? A nuk është kjo paradoksale? Kjo do të thotë që krishterimi është më i përhapuri në mbarë botën, më i larmishëm nga ana kulturore, më gjithëpërfshirës nga ana kulturore, por më përrjashtuesi në pretendimet e tij. Si funksionon kjo?

Arsyeja për të Dyja

Të kuptuarit e këtij paradoksi të supozuar përmbledhet në të kuptuarit e kësaj historie, dhe mënyra se si futesh në zemër të tregimit është duke e bërë një pyetje. Një nga mënyrat më të mira për të kuptuar një histori është t'i bëni asaj pyetjen e duhur dhe më pas ta lini të përgjigjet vetë. Pyetja që do të bëjmë është kjo: Pse etiopiasit po e lexon me kaq vëmendje rrotullën e Isaisë?

Ky njeri kishte shkuar nga mbretëria e tij deri në Jerusalem për të adhuruar në tempull. Pse vallë do ta bënte këtë? Para së gjithash, le të mendojmë se kush ishte ai. Ai ishte kreu i thesarit të mbretëreshës - ai praktikisht kishte arritur majën. Në termat e sotëm, ai ishte CFO (*shqip: Shef i Financave*) i vendit të tij. Në fakt, ai kishte më shumë pushtet sesa ka sot Sekretari i Thesarit i Shteteve të Bashkuara. Ai kishte fuqi dhe sukses, por le të kujtojmë se ai bëri një sakrificë të madhe duke u bërë eunuk, dhe kjo ishte në një

kohë kur pasardhësit e dikujt ishin të një rëndësie kritike. Kulturat e lashta nuk ishin aq individualiste sa ne sot. Sot, shumica e njerëzve e masin vetëvlerësimin e tyre kryesisht me arritjet e tyre, por në atë kohë, vetëvlerësimi vinte nga pozita e familjes suaj. Kishit nder dhe krenari vetëm nëse gjendja e familjes suaj ishte e mirë. Nuk kishit se si të kishit ndonjë lloj trashëgimie nëse nuk kishit fëmijë; bijtë dhe bijat e tua *ishin* trashëgimia jote. Megjithatë, ja ku ishte një njeri që sakrifikoi të gjitha këto për të marrë pushtetin. Ai kishte hequr dorë nga vetë ideja për të pasur një familje në një kulturë krejtësisht të dominuar nga familja. Ndër të tjera, kjo nënkuptonte vetminë.

Pra, pse një njeri do të ndërmerre një udhëtim mijëra kilometrash për të lënë kulturën e tij, fenë e tij dhe postin e tij? Ky ishte një pozicion, meqë ra fjala, që mund ta rrezikonte duke bërë një udhëtim me mijëra kilometrash, një-vjeçar. Mundësia që dikush të zinte vendin tuaj do të kishte qenë shumë e mirë - për të mos përmendur sa i rrezikshëm mund të ishte një udhëtim kaq i gjatë.

Përgjigja është se duhet të ketë pasur një boshllëk të madh tek ai. Feja e tij nuk mund ta mbushte atë. I gjithë pushteti dhe suksesi i tij nuk mund ta mbushnin atë. Për çfarë arsye tjetër do të interesohej ai për Perëndinë e Biblës, do të pyeste veten nëse kishte diçka për të në Jerusalem dhe do të shkonte deri në tempull? Ja një gjë që dimë: kur ai arriti në tempull - pas gjithë atij udhëtimit, gjithë asaj sakrifice - ata nuk do ta kishin lënë të hynte.

Tempulli dhe i gjithë adhurimi i tij rregulloheshin nga Ligji i Moisiut. Ligji i Moisiut, i cili është ende një enigmë për lexuesit modernë, i kishte të gjitha këto rregulla se kush mund të hynte në tempull dhe të adhuronte Perëndinë dhe kush jo. Për shembull, nëse keni prekur një trup të vdekur, jeni përjashtuar nga tempulli për një kohë të caktuar. Nëse kishit myk në shtëpinë tuaj, ishit të përjashtuar. Pse? Të gjitha këto rregulla u vendosën për t'ju përçuar një ide shpirtërore. Shpesh nuk kuptohej, por ideja ishte se Perëndia është i shenjtë dhe ne jemi mëkatarë dhe nuk duhet që thjesht të futemi në banesën e Perëndisë pa u pastruar. Diçka duhej bërë për mëkatin. Të gjitha ato rregulla dhe rregullore ishin si mjete ndihmëse vizuale në përpjekje për t'ua komunikuar atë.

Por disa nga rregullat i përjashtonin njerëzit përgjithmonë. Një nga rregullat ishte se ata që ishin tredhur nuk mund të hynin *kurrë* për ta adhuruar Zotin. Sipas kësaj logjike, etiopiasit ka të ngjarë të kalojnë gjithë këtë telashe dhe thjesht ta gjente veten të përjashtuar dhe lënë jashtë. Mund ta imagjinoni zhgënjimin! Pra, pse ai ende vendosë të shqyrtojë librin e Isaias gjatë rrugës për në shtëpi?

Ndoshta çelësi është në atë se në cilën pjesë të Biblës po lexonte etiopiasit. Teksti i cituar në pasazh është nga Isaias 53, kështu që ai po lexonte nga kapitujt 40-të dhe 50-të të quajtur "Këngët e Shërbëtorit". Në kapitullin 56, i cili nuk është shumë larg nga vendi ku po lexonte, ai do ta kishte parë këtë:

"Asnjë i huaj të mos thotë: 'Zoti do të më përjashtojë nga populli i tij' dhe asnjë eunuk të mos ankohet: 'Ja, unë jam një dru i thatë', sepse kështu thotë Zoti: 'Eunukëve që i përmbahen me vendosmëri besëlidhjes sime, do t'u jap një emër që do të vlejë më

tepër nga ai i bijve dhe i bijave; do t'u jap atyre një emër të përjetshëm që nuk do të fshihet kurrë.”

E imagjinoni dot reagimin e tij? Ai do të ishte ulur atje duke thënë: “Prit një minutë. Nuk di asnjë mënyrë tjetër për të përcjellë emrin tim *përveçse* nëpërmjet djemve dhe vajzave. Cili është ky emër i përjetshëm që nuk do të fshihet kurrë?”

Atij i thuhet në termat e tij kulturorë se ka një shpëtim që shkon përtej jo vetëm fuqisë dhe suksesit, por edhe familjes. Teksa po lexon, ai befas kupton se ekziston kjo figurë e çuditshme dhe enigmatike e quajtur "shërbëtori" në gjithë këtë pjesë të Shkrimit (që është edhe arsyeja pse quhet "Këngët e Shërbëtorit"). Zoti vazhdon të thërrasë dikë, "Shërbëtori im". Dhe ky person po vuan. A e kuptoni pse një eunuk do ta shikonte këtë pasazh?

Le t'i hedhim një vështrim tjetër vargut specifik që po lexonte: “I keqtrajtuar dhe i përlulur, nuk e hapi gojën. Si një qengj që e çojnë në thertore, si një dele e heshtur përpara atyre që i qethin nuk e hapi gojën. U çua larg nga shtypja dhe nga gjykimi; dhe nga brezi i tij kush mendoi se ai ishte larguar nga toka e të gjallëve?” E vutë re pjesën për brezin? Në këto vargje, dikush po i jep fund vullnetarisht pasardhjes së tij familjare, njësoj si një eunuk, dhe po bëhet një qengj për t'u therur. Në fakt, nëse shkoni pak më tutje, Isaia 53:8 thotë “U çua larg nga shtypja dhe nga gjykimi; dhe nga brezi i tij kush mendoi se ai ishte larguar nga toka e të gjallëve dhe ishte goditur për shkak të shkeljeve të popullit tim?”.

Ndërsa etiopiasit u ul aty duke pyetur veten se kush vallë është ky person, Filipi u ngjiti dhe i ofroi ta ndihmonte të kuptonte atë që po lexonte. Ai u kthye nga ai menjëherë dhe e pyeti: “Të lutem, për kë e thotë profeti këtë? Për veten e vet apo për ndonjë tjetër?”. Filipi i tha se po, profeti po fliste për dikë krejt, krejt, krejt tjetër – dikë absolutisht unik. Është Jezu Krishti, i lindur në një grazhd, i cili vdiq në kryq.

Mund ta imagjinoj Filipin duke i thënë mikut të tij të ri diçka si kështu: “Jezusi u bë qengji që u ther. Jezusi u bë si një lebroz për lebrozët. Ai u bë si eunuk për eunukun. Me fjalë të tjera, Jezu Krishti ishte përjashtuar. A nuk e sheh, o miku im i ri, se ligji i Moisiut po tregonte vetëm një të vërtetë shpirtërore? Të gjithë jemi si eunukë. Të gjithë jemi të përjashtuar nga prania e Zotit. Për shkak të mëkateve tona, askush nuk e do Perëndinë me gjithë zemrën, shpirtin, forcën dhe mendjen e tij. Askush nuk e do të afërmin e tij si vetveten. Askush nuk mund të hyjë. Ne të gjithë meritojmë të përjashtohemi dhe të humbasim. Por Jezu Krishti u përjashtua në kryq në vendin tonë. Ai tha: ‘Zoti im, Perëndia im, pse më ke braktisur?’ Ai përjetoi braktisjen e Perëndisë që ne meritojmë. Ai u përjashtua që të mund të hynim brenda. Ai u bë i papastër që ne të mund të pastroheshim. Ne kurrë, asnjëherë nuk do të mund ta pastronim veten dhe të ishim mjaft të mirë vetë, por Jezu Krishti e ka bërë atë për ne.” Ky është lajmi i mirë i Jezusit.

Tani këtu lind një pyetje: Pse feja më gjithëpërfshirëse është më përjashtuesja dhe pse përjashtueshmëria e krishterimit do të sillte këtë gjithëpërfshirje?

Së pari, le të shohim se çfarë bën krishterimi. A e kuptoni pse krishterimi *do të* ishte më fleksibël kulturalisht? Po sikur shpëtimi të ishte kështu: Perëndia zbriti si gjeneral dhe tha: "Kushdo që i bindet gjithçkaje që unë u them do të jetë i bekuar dhe i suksesshëm"? Shpëtimi do të ishte nga një Perëndi i fortë te njerëzit e fortë. "Mblidhni forcat tuaj dhe jini aq të bindur sa të jetë e mundur."

Nëse shpëtimi do t'i jepej vetëm të fortëve nga të fortët, krishterimi do të ishte një fe e asgjëje tjetër veçse ligjeve. Ju do të dëshironit të jeni plotësisht të bindur, sepse jeni të bekuar dhe të suksesshëm vetëm nëse jeni absolutisht të bindur. Krishterimi madje do t'ju tregonte se çfarë të hani dhe si të visheni dhe gjithçka. Që të bëheni i krishterë, do të duhej të linit plotësisht pas kulturën tuaj.

Ky nuk është shpëtimi i ungjillit. Cili është ai shpëtim? Zbulesa më e thellë e natyrës së Perëndisë është në kryq. Lavdia më e madhe e Perëndisë shihet në mënyrën se si ai ishte i gatshëm të humbiste gjithë lavdinë e tij. Bukuria e tij më e madhe është se ai ishte i gatshëm të humbiste bukurinë e tij. Ai u dobësua, vdiq dhe u ringjall, për të marrë dënimin tonë dhe zemërimin hyjnor. Ishte e vetmja mënyrë për të na falur, e vetmja mënyrë për të na shpëtuar dhe e vetmja mënyrë për t'i dhënë fund të keqes një ditë, pa na dhënë fund neve. Prandaj, ideja e dobësisë është qendrore në zemrën e krishterimit.

Kjo do të thotë se krishterimi nuk është një fe relativiste. Ekziston një standard universal moral që duhet të ndjekin të gjitha kulturat. Por krishterimi gjithashtu nuk është vetëm një fe e së vërtetës; është një fe e së vërtetës e thënë *me dashuri*. Edhe pse ka norma, ka një sasi të madhe lirie. Ka një butësi dhe një ngurtësi te krishterimi. Prandaj, ka kuptim të plotë që krishterimi është kaq fleksibël, sepse shpëtimi nuk është nëpërmjet mbajtjes së ligjit; është përmes hirit.

Kur bëhemi të krishterë, identiteti ynë ndryshon, duke na dhënë aftësi të reja për të kapërcyer barrierat tona të vjetra të përjashtueshmërisë. Për shembull, nëse e merrni vetëvlerësimin tuaj nga të qenit një person punëtor, ka të ngjarë të shikoni me përçmim njerëzit që i konsideroni dembelë. Nëse e merrni vetëvlerësimin tuaj nga të qenit një person emocionalisht intuitiv, ndoshta nuk ju pëlqejnë njerëzit racionalistë, të cilët mund t'ju duken të ftohtë; dhe nëse e merrni vetëvlerësimin tuaj nga të qenit një person racional dhe i arsyeshëm, mund të hiqni dorë nga shqetësimet emocionalisht intuitive. Dhe nëse e merrni vetëvlerësimin tuaj nga të qenit një person racional dhe i arsyeshëm, mund të hiqni dorë nga shqetësimet e intuitit emocional. Me fjalë të tjera, nëse arrini shpëtimin tuaj, nëse imazhi juaj për veten bazohet në diçka që arrini, do të prireni të shikoni me përçmim kulturat e tjera, klasat e tjera, grupet e tjera profesionale, lloje të tjerë njerëzish dhe temperamente të tjera.

Por ungjilli nuk fillon me forcën ose me përmbushjen e shpëtimit tuaj; fillon me dobësi. Ai thotë se Perëndia ju jep një shpëtim të vërtetë që mund ta merrni vetëm kur e përlulni veten dhe pranoni nevojën tuaj. Krishterimi nuk është për të fortët; është për njerëzit që e dinë se nuk janë. Është për ata që pranojnë se janë të dobët, dhe më pas e marrin atë me anë të hirit dhe kofirmohen në qiell dhe vlerësohen nga dashuria e Perëndisë. Nuk mund të ndihesh superior ndaj askujt – dhe kjo është ajo që i thyen barrierat kulturore.

Çelësi i të gjithave është ky: në zemër të Biblës është Jezusi - Perëndia bëhet njeri. Fryma nuk e solli vetëm Filipin në këtë takim. Fryma e drejtoi gjithashtu këtë politikan etiopias te teksti, i cili është ndoshta zemra e gjithë Biblës, sepse ka të bëjë me sakrificën zëvendësuese.

Gjithçka në Bibël tregon se si shpëtimi ynë nuk është diçka që ne e arrijmë, dhe se si Jezu Krishti zuri vendin tonë, si zëvendësuesi ynë, dhe bëri atë që kërkohej për të na shpëtuar. Bibla ndonjëherë flet për atë që bëri Jezusi në gjuhën e fushëbetesës. Ai luftoi fuqitë e mëkatit dhe vdekjes për ne. Ndonjëherë është gjuha e tregut. Ai e pagoi borxhin tonë. Ndonjëherë është gjuha e tempullit. Ai dha sakrificën përfundimtare që ne të mund të pastrohemi dhe të jemi të pranueshëm në sytë e Perëndisë. Ndonjëherë është gjuha e gjykatës. Ai qëndroi në vendin tonë dhe mori gjykimin tonë dhe pagoi dënimin tonë. Dhe kalimi nëpër secilin prej të gjithë atyre fjalorëve të ndryshëm është *zëvendësim*.

Lloji më bindës, më jetë-ndryshues, më i mrekullueshëm është ai për dikë që vdes për të shpëtuar njerëzit e tjerë. Vite më parë, kur romani i fundit *i Harry Potter* ishte gati të dilte dhe të gjithë po pyesnin veten se si vallë J.K. Rowling do t'i sillte të gjitha në një përfundim, unë gjithmonë e dija (edhe pse askush nuk më besonte!). E dija që Harry duhej të vdiste për miqtë e tij në mënyrë që t'i shpëtonte ata. Pse? Sepse nuk ka histori më bindëse, të mrekullueshme, transformuese. Nëse e dini se dikush e ka bërë atë për ju, asgjë nuk ju ndryshon më shumë se kaq.

Disa prej jush mund ta dinë se historia ime e preferuar nga Çarls Dikens është *Rrëfenja e Dy Qyteteve*. Në përfundimin e famshëm, Sidnej Karton hyn në birucë ku rivalit të tij - që i ngjan atij - do t'i pritej koka në gijotinë. Kartoni e kontrabandon këtë njeri, Çarls Darnejin, nga burgu dhe zë vendin e tij. Ai e zë vendin e njeriut të dënuar. (Filmi i vitit 1935 me Ronald Kolman në rolin kryesor nxjerr në pah në mënyrë të bukur temat e krishtera.) Ka të burgosur të tjerë përreth, duke përfshirë edhe një rrobaqepëse të re që pret të ekzekutohet. Ajo sheh njeriun që mendonte se ishte Darnej, e shikon atë dhe e kupton se ai ishte dikush tjetër. Ajo e pyet: "A po vdes për të?" Ai përgjigjet: "Dhe për gruan e fëmijën e tij". Në filmin e vitit 1935, ajo thotë diçka të ngjashme me: "I huaj, nuk mendoj se mund të përballem me vdekjen time, por ndoshta nëse mbaj dorën e dikujt aq trim sa ti, do të mund t'ja dal". Ai pranon dhe shkojnë së bashku në gijotinë. Ajo u transformua dhe u forcua nga sakrificat e tij zëvendësuese, dhe kjo madje nuk ishte për të.

Sa më tepër do të bëheni *ju* një agjent për përhapjen e ungjillit, për një jetë sakrifice, për të dorëzuar veten që të tjerët të mund të jetojnë? Sa më shumë do të transformoheni

nëse e kuptoni sakrificën zëvendësuese të Perëndisë për ju dhe e bazoni jetën tuaj mbi të?

Një lutje

Atë, faleminderit që dërgove Jezusin për të bërë sakrificën përfundimtare për ne. Ndërsa kërkojmë të ndërtojmë kishën tënde siç bënë të krishterët në librin e Veprave të Apostujve, të kërkojmë të na drejtosh drejt takimeve si Filipi dhe etiopiasit. Na ndihmo të shfaqim gjithëpërfshirjen dhe përjashtimin radikal të historisë tënde në një mënyrë shtrënguese dhe jetë-ndryshuese për ata që na rrethojnë. Në vend që t'i shpërfillim ata të racave, temperamenteve, statuseve ekonomike ose kulturave të ndryshme, na ndihmo të jetojmë si dëshmitarë të dashur për ta derisa të na ftojnë të ndajmë lajmin e mirë të ungjillit dhe të kënaqemi në tokën e përbashkët që ai ka për të gjithë ne. Ne e bëjmë këtë lutje në emrin tënd të shenjtë,

Amen.